

VËSHTRIM NË TË DREJTËN DOKESORE SHQIPTARE

1. Kanuni - ligj popullor

Në rrjedhë të shekujve e deri aty nga Lufta e Parë Botërore, në bashkësitë e lira fshatare, përgjithësisht në malësitë shqiptare, po diku-diku dhe në ultësira, ka vepruar një e drejtë dokesore, kanuni, pra një ligj popullor, një kompleks normash tepër të përcaktuara e të detyrueshme për të gjithë, pavarësisht nga gjendja sociale a shtresa përkatëse e njeriut. Ky kanun, në parim pësonte ndryshime e risime në artikuj të veçantë të tij, vetëm me vendime të kuvendeve popullore të përgjithshme - burrë për shtëpi. Më i ruajtur ka qenë në malësitë e Shqipërisë së Epërme, duke përfshirë këtu Kosovën, trojet shqiptare në Mal të Zi e në Maqedoninë Perëndimore dhe në Jug: në Labëri e në Çamëri. Kjo e drejtë ishte e ndarë në variante, si të thuash, në "dialekte" e në "të folme", sipas veçorive krahinore a ndërkrainore të viseve të ndryshme. Me këto norma dokesore rregullohej bashkëjetesa e marrëdhëniet sociale e pronësore në mes banorëve të maleve; ai ishte themeli i njëfarë vetëqeverisjeje, të thuash një "autonomi" në këto vise, ku ligjet e sistemit feudal e të pushtuesve të ndryshëm nuk mundën të ndërhyjnë e të zënë vend në mënyrë të qëndrueshme. Kjo e drejtë dokesore zëvendësonte mungesën e një ligji kombëtar të kultivuar. Duhet ditur se këto norma ligjore të traditës kanë qenë ngulitur kaq thellë në mendësinë e banorëve të maleve, sa disa teprica të tyre kanë mbijetuar aty-këtu, ndër male, edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Studiuesja angleze Edith Durham, eksploruese e malësive shqiptare në fillim të shekullit XX, thotë se *malësorët shqiptarë besojnë e respektojnë më shumë ligjet e Lekë Dukagjinit, pra këtë të drejtë dokesore, se sa nga Bibla Dhjetë Urdhërimet e Zotit, se sa ligjet e Kuranit.*

Kompleksi i këtyre normave ligjore dokesore është njohur në popull përgjithësisht me emrin "Kanuni i Maleve", "Doket e Maleve", po dhe me emra krahinorë e sipas varianteve: "Kanuni

i Malësisë” (për malësitë e Alpeve shqiptare), **“Kanuni i Lekë Dukagjinit”** (ashtu si është zbatuar në Dukagjinin Mesjetar), që përfshinte pjesën qendrore të Shqipërisë Veriore: në Jug të Drinit (Lumë, Pukë, Mirditë, po dhe në Kosovë), **“Kanuni i Arbnit”** a **“Kanuni i Skandërbegut”** (në Shqipërinë e Mesme, Dibër, Pollog), **“Kanuni i Labërisë”** (Labëria në Jug). Gjeçovi, duke shprehur mendimin se kjo e drejtë në themel ka shtrirje mbarëkombëtare, shënon se në Labëri, në krahun e saj, në anë të Gjirokastrës, thuhet **“Me ba kuvend mbas kanunit të Pirrit”**, pra e quanin **“Kanuni i Pirros”**, e kjo ka një domethënie të qartë historike, ruajtur në mendësitë e banorëve të maleve të Labërisë.

Për njësi më të vogla krahinore kemi: **“Kanuni i Pukës”**, **“Kanuni i Lumës”**, **“Kanuni i Mirditës”** (variante të KLD), **“Kanuni i Kurbinit”** (KK), **“Kanuni i Musë Ballëgjinit”**, **“Kanuni i Çermenikës”** (Variante të **“Kanunit të Arbënit”**), **“Venomet e Kurveleshit”**, **“Venomet e Himarës”** (Variante të **“Kanunit të Labërisë”**), **“Venomet e Sulit”** (në Çamëri) e kështu me radhë.

Kjo e drejtë popullore nuk ka qenë e shkruar e aq më pak e kodifikuar, po është e trashëguar nga brezi në brez me besnikëri, nëpërmjet pleqnarëve (grykuesve popullorë), nëpërmjet të moshuarve e kreut të çdo familjeje, po edhe nga çdo njeri i këtyre bashkësive fshatare. Kjo është e lidhur ngushtë me jetën e tyre, me praktikën e veprimtarisë së përditshme, me detyrat e të drejtat e çdo njeriu e pozitën e tij në familje e në shoqëri. Në të gjeje norma (si mund të themi, nene të veçanta) për çdo rast konkret ose me anë të përgjasimeve e të motërzimeve a me anë të zgjidhjeve logjike, bazuar në një botëkuptim, në një mendësi të shoqërisë fshatare me tradita patriarkale; aty gjeje norma për çdo dukuri a element të veçantë të së drejtës familjare, të së drejtës civile, të së drejtës së pronës, të së drejtës administrative dhe të asaj penale.

2. Veçori etiko - morale

Në këtë të drejtë dokesore, përgjithësisht të tëra variantet, të Shqipërisë së Epërme, të Mesme dhe në Jug, në ato norma juridike që janë më të mirëfillta e të traditës vendëse më të hershme, kanë si parime themelore: *barazinë, lirinë, atdhetarizmin, nderin, burrninë, besën, mikpritjen, ndihmën e ndërsjelltë, ndjeshmëri të theksuar të përkatësisë në bashkësinë sociale*. Këto mendësi e psikika, të

ngritura në kult, mbizotërojnë në tërë materialin dëshmues kanunor.

Në këto gjykime përshkohet fryma se njerëzit janë të barabartë, pavarësisht nga gjendja sociale; çdo burrë *"peshon 400 derhem në kandarin e tij"* e nuk ke të drejtë ta nënvleftësosh e ta nëpërkëmbësh. Në norma, disa herë bëhet fjalë për barazinë në gjak, pra brenda fafesisit, po në përmbajtje të përgjithshme del se secili ka një vend të caktuar e të nderuar në bashkësinë shoqërore krahinore. Në të vërtetë, në banorët e maleve, ka mbizotëruar te secili ndjenja e krenarisë, e pavarësisë në veprimet vetjake e në vlerësimet për vete e për të tjerët; çdo njeri bënte përpjekje të sillej e të vepronte, të fliste me fisnikëri, duke e konsideruar veten të barabartë me të tjerët. Në jetën shoqërore krahinore të traditës, të quheshe *"burrneshë"* a *"burrneshë e dheut"*, *"burrë"*, a *"burrë i dheut"*, duhej të ishte *i mençur*, që flet gjithnjë fjalë të peshuara, *i besës, mikpritës, i ndershëm, trim e atdhetar*, që nuk bën hile në punët shoqërore a të ndërsjellta me të tjerët, njeri i punës pa dredhi, që ndihmon materialisht e shpirtërisht të varfërit e fatkeqët e që kurrë nuk i përbuz ata. Ai njeri që nuk i kishte këto virtyte, nuk mund të quhej burrë, veçse mashkull që gjallon mbi këtë tokë. Pra, njeriu nuk lind i pavlerë, po bëhet i pavlerë nga veset e veprimet e tij të panjerëzishme. Ta zemë, nëse një plak gjygi bën pleqërira (gjkime) në rrugë të padrejta e nuk i mbahet së vërtetës, qoftë ky dhe nga krerët e mëdha, ndëshkohet për fajet e tij në gjykime. Kështu, mblidhen burrat e fshatit, të dheut a të krahinës në kuvend dhe zbrazin të gjithë armët përpjetë e kështu *"vrasin pleqrimin"* e atij që ka gjykuar shtrembër e me anësi. Mbas asaj dite plaku që *"iu vra pleqnia"* nuk ka më të drejtë të pleqnojë e kush ma për plak gjykimi nuk e merr" (DGJ, f. 13, nr.10).

Në kanun e në mendësinë e popullsisë, ku vepronte kjo e drejtë e traditës, mbrojtjes së nderit i jepej një vend tepër i veçantë e çdo cenim i nderit të një njeriu dënohej rëndë, sa shpesh herë kalonte deri në marrjen e jetëve, tragjedi kjo mjaft e dhimbshme. Çdo lloj fyerjeje publike ishte marrje e nderit, ta zëmë, t'i thuash kujt se *"rrenë"* në sy të burrave të mbledhur në kuvend, *ta pështysh, ta shtysh, ti biesh në grusht, ti prishësh besën, ti dhunosh (ngacmosh) mikun a punëtorin në bukë të tij, ti thyesh shtëpinë a vathin, ti heqësh kapakun e vegshit* (enë prej dheu, në të cilën zihet gjella pranë zjarrit), për të parë se çka brenda, të koritësh tryezën në sy të mikut, kur i zoti i shtëpisë kruan, fshin a lëpin kupën ku po han bashkë me

mikun (KLD, f. 65-66, neni 601; EDZSH, f. 105-107, neni 91-93). Nderi i gruas ruhej në mënyrë të veçantë sipas gjykimit se *“shtëpia, e mirë a e keqe asht e mbajtur nga grueja”*, *“shtëpia asht gruaja se burrat janë miq në shtëpi”* (EDZSH, f. 108, neni 95; DG, f. 22). Të tëra këto çnderime dënohen, dikush më lehtë e dikush më rëndë, me ndërmjetësi, por ato që rëndonin më shumë e që detyrimisht i ndante vetëm gryka e pushkës, ishin: *ti pritej në besë miku, ti përdhunohej gruaja, ti merrej arma*. Këto nuk kishin ndërmjetësi e paguheshin vetëm me vrasje. Vrasja e babës a e vëllait edhe mund të falej, po miku, gruaja e arma kurrsesi. Të dhunuarit e gruas çnderonte jo vetëm familjen e saj, por dhe tërë fshatin e miqësinë, po kështu dhe dhunimi a vrasja e mikut. Me këto ligje dokesore, miku e gruaja ishin tepër të siguruar në udhëtimet e punët e tyre jashtë shtëpisë. Këto ligje i përkasin një botëkuptimi mesjetar, po për ato kohë ishin siguri e ekuilibër social me peshë në jetën e bashkësive të lira fshatare.

Besa, fjala e dhënë, betimi, në kanun e në mendësinë fshatare të lirë kanë pasur një forcë tepër të madhe ligjore, morale dhe hyjnore. Vlera e besës është sintetizuar dhe në fjalët e urta të popullit: *“Ke del fjala, del shpirti”*. *“Kur jep fjalën, jep jetën”*, *“Besa e shqiptarit si purtekë e arit”*, pra që nuk mund të thyhet kurrë, *“Burri mbahet për fjalësh e demi për brirësh”*. Instituti i besës ka ndikuar shumë, për kohën, në pajtime e harmoni shoqërore, në shfajsimë, në lidhjet krahinore e ndërkrasinore, ka qenë një forcë kohezioni me natyrë kombëtare.

3. Kuadri historik

Për të kuptuar si duhet, sadopak, sesi ka lindur ky ligj popullor, si është zhvilluar, cilët janë krijuesit e përpunuesit e herëpashershëm të tij (në bazë të kushteve të reja shoqërore në zhvillim), si ka funksionuar në praktikë, si e pse është ruajtur deri në shek. XX, më parë duhen njohur disa veçanësi themelore të rrugës së zhvillimit etnik, historik e kulturor të popullit shqiptar.

Së pari, populli shqiptar, ndër shekuj, që nga Lashtësia Ilire, gjatë Mesjetës e deri në Kohë të Re, ka qenë pre (gjah) i pushtuesve të ndryshëm të ardhur nga Lindja e nga Perëndimi, nga Veriu e nga Jugu. Pushtuesit kanë vërshuar për ta plaçkitur atë, për ta nënshtruar, për të rrëmbyer pasuritë natyrore e më tepër ato të punës së tij, të energjive të tij krijuese e transformuese në zhvillim e

ecje përpara. Në këto rrethana, nuk u formua asnjëherë një shtet kombëtar, që të bashkonte, së paku, pjesën më të madhe të trojeve stërgjyshore të këtij populli; nuk pati ndonjëherë as ligje kombëtare të kultivuara të një shteti të centralizuar e as për principata pak e shumë të fuqishme e me shtrirje të gjerë në këto troje; është fjala për principata me ngjyrë kombëtare. Shteti i Arbërit (shek. XII-XIII), a disa principata të periudhës para pushtimit osman, nuk patën ndonjë jetë të gjatë e ndonjë forcë kohezioni të veçantë, që të bënte të mundur të vihen ligje shtetërore të natyrës mbarëkombëtare. Jeta e këtyre bërthamave shtetërore kaloi në luftëra mbrojtëse, po dhe për zgjerim territoresh brenda trojeve kombëtare, nga njeri a nga tjetri. Me sa duket, në anën juridike në këto shtete më tepër u përdorën ligje të organizimit për luftë, *ligje popullore vendëse* dhe ligje të huajtura nga traditat juridike të popujve të tjerë prej të cilëve, në një periudhë a në një tjetër, ishin pushtuar e prej tyre kishin mbetur copëza të të drejtave juridike shtetërore e të administratës së të huajve. Edhe shteti i Skënderbeut, që shtrihej në një pjesë të kufizuar të trojeve të këtij etnosi (shek. XV), filloi e mbaroi, u shua me luftëra të një qëndrese mbinjerëzore kundër pushtimit osman. Pra u muar vetëm me luftëra e, ashtu si bërthamat shtetërore të shekujve të mëparshëm të Arbërit, shtrytëzoi po ato norma ligjore popullore a të huaja që i gjeti të gatshme, si ato bizantine, veneciane e huazime juridike nga shtete e popuj të tjerë. Historia nuk njeh asnjë burim që të vërtetojë se në shtetin e Skënderbeut të jenë hartuar ligje shtetërore të natyrës mbarëkombëtare (ÇHSD, fq. 40-44). Tërthorazi mësojmë se në kohë të tij u përdorën ligjet dokesore e prurje të huaja, për të vënë rregull e ekuilibër social, për një rregullsi ekonomike e shtetërore, po dhe për lidhjet krahinore e ndër-krahinore. Gojëdhëna flet për kodifikim ligjesh dokesore nga Lekë Dukagjini e Skënderbeu, po kjo nuk ka mbështetje shkencore, është vetëm fantazi. Shumë-shumë, ata mundet të kenë bërë pleqërime sipas kanunit dokesor ose dhe mund të kenë futur disa norma të reja, gjysmëpopullore e gjysmështetërore si personalitete shtetërore e si klasë fisnikësh. Mendimin se këta dijetarë kanë bërë gjykime me ligje popullore e se në të drejtën dokesore shqiptare kanë shtuar e kanë rregulluar dy-tri norma, e kanë mbështetur dhe studiuesit e ndryshëm.

Gjatë sundimit osman (shek. XV-XX), malësitë shqiptare, me

forcën e qëndresës, arritën të sigurojnë një farë autonomie me vetëqeverisje krahinore, sidomos disa malësi të Shqipërisë së Epërme (Malësi e Madhe, Mirditë - Dukagjin Mesjetar), Malësi e Gjakovës, Mat, Dibër, Lumë e vise të tjera dhe në Jug: Kurveleshi, Himara, vise të caktuara të Çamërisë (si Suli etj.). Në këtë qeverisje, shpesh herë tepër të mbyllur brenda krahinave të veçanta ose brenda dy a tre krahinave bashkë, funksionoi me tërë fuqinë e tij ky ligj popullor, për të vënë ekuilibër social, për çdo veprimtari familjare, bashkëfshatare, krahinore ose ndërkrahinore, po dhe si mbrojtje nga rreziku i jashtëm. Pra, kushtet historike që u përmendën, e ruajtën të gjallë dhe e zhvilluan këtë ligj dokesor të shqiptarëve, me variantet e tij sipas krahinave, po me një bazë normash themelore krejt të njëjta ose të përafërta; pati larmi sipas kushteve gjeografike, burimeve ekonomike, sipas trevës më të hapur apo më të mbyllur ndaj qendrave urbane ose dhe në lidhje me administratën osmane, me institucionet fetare e me besimet përkatëse të popullsisë. Ky ligj përforcoi organizimin krahinor e ndërkrahinor në qëndresën kundërosmane e, me revolta kryengritëse, vetë bashkësitë fshatare ndër male siguruan një farë autonomie. Kundërshtuan vendosjen e një administrate të qëndrueshme të shtetit osman, po kështu nuk jepnin taksa e as ushtarë. Qëndresa kundër pushtuesit i përforcoi këto ligje popullore, po, në përgjithësi, imponoi dhe një organizim shoqëror tepër arkaik-patriarkal të mesjetës, pra si një kthim mbrapa, njëfarë vetëmbyllje, që ia detyruan rrethanat e qëndresës. Vetë e drejta dokesore e maleve ka qenë një mjet i fuqishëm qëndrese e sigurie, duke qenë, veç së tjerash, e lidhur fort me tradita morale e besimesh të vjetra të vendit.

Së dyti, nuk mund të kuptohet si duhet historia e funksionet e këtij ligji dokesor pa e vështruar atë brenda kompleksit të gjerë kulturor të traditës shqiptare me rrënjë tek Arbëri Mesjetar e më tej, deri tek iliro-trakët, të lidhjet kulturore paleoballkanike, pavarësisht nga disa shtesa e ndikime të kohëve të ndryshme, më të vonshme. Ndër malësitë shqiptare ka ekzistuar përgjithësisht një ekonomi fshatare me burime kryesisht natyrore; lidhjet me tregun, me këmbimin sipas rrethanave, kanë qenë herë më të dendura e herë tepër të kufizuara, po gjithnjë të dorës së dytë në ekonomitë familjare, çka pasqyrohej edhe në këto norma juridike.

Nuk u ruajt vetëm shqipja si bijë e ilirishtes së lashtë, si një degë

krejt e veçantë në familjen e gjuhëve indoeuropiane, po u ruajtën, brenda këtij qarku kulturor, disa lloje të veshjeve të lashta, natyrisht të evoluara e të ndryshuara bashkë me kohën: *Veshja me xhubletë* - një petk i rëndë grash, në formë këmbane, e i valëzuar, që nga koha e bronxhit, e po këtyre viseve; kështu kemi *dalmatikën* ndër ilirë e pasardhësen e saj ndër shqiptarë, *strugën, llabanian* (për t'u mbrojtë nga shiu), *tallaganin* (një lloj si pelerinë mbështjellëse në pjesën e sipërme të trupit), *pështjellaku* (një fund me kapje e hapje në një anë), *opingat me retra* (nga lëkurë bagëtish). Janë ruajtur elemente të lashta, si: *brezi me rrema* në Kurbin e në Baz (Mat), *tufat e brezit mbrapa e përparja* (stravecja) e *Mirditës* e tëra nga penj që varen poshtë; si tipologji janë me rrënjë prehistorike.

Elemente të vjetra të kulturës mesdhetare vërejmë në ndërtimet e banesave prej guri, përdhese, në ato në gjysmëkat a në ato të tipit kullë, përshtatur me kushte historike të veçanta të këtij populli.

Vajtimi i grave në vdekje e *gjama* e burrave, kryesisht në disa malësi të viseve shqiptare, bien me vete elemente të lashtësisë ballkanike (trako-ilire e greke) e mesdhetare (vendet e Lindjes, Egjipti e me radhë).

Janë ruajtur ndër shqiptarë *rite, mite e besime të një shtrese të lashtë* parakrishtere e paraislame. Në *Dragoin e Kuçedrën* shqiptare vërejmë mbijetojat e hyjnive të qiellit e të tokës, të rrufesë e të shtrëngatës; në mite etnologjike vërejmë gjurmë të *heronjve kulturorë* të lashtësisë; në dy kryevepruesit vëllezër të eposit të Veriut vërejmë një tip të veçantë të vëllezërve açvinë - dioskurë. Gjurmë të hyjnive të natyrës, të maleve, i vërejmë në *Zanën* e në *Bariun e Shenjtë* të besimeve shqiptare, me rrënjë iliro-trake, paleoballkanike. Kështu mund të vazhdonim edhe me shumë elemente kulturore të traditës së lashtë të këtij populli.

Pra, brenda këtij kompleksi etnokulturor u ruajtën e u zhvilluan dhe normat e së drejtës popullore, aq të nevojshme për rregulla të detyrueshme për të gjithë, pa ndryshim shtrese shoqërore, në bashkësitë e lira fshatare. Koncepti i njeriut të lirë, me të drejta e detyra të barabarta, ishte shprehur qartë, në normat më të mirëfillta të kësaj së drejte.

4. E drejtë popullore në evolucion

Kjo e drejtë dokesore u ruajt e u zhvillua duke u mbështetur në

disa faktorë: 1. Në kompleksin e kulturës etnike si popull; 2. Ligjet e pushtuesit binin në kundërshtim me interesat jetike të popullsisë së lirë; 3. Ligjet e pushtuesit nuk zgjidhnin çdo problem jetik të fshatarësisë, por vetëm ato që i interesonin atij; 4. Tradita është forcë e madhe ruajtëse e gjendjes më të vjetër.

Kjo e drejtë dokesore ishte shtrirë e vepronte në tërë damarët e jetës shoqërore të bashkësive fshatare ndër male, por nuk mund të ishte kurrësi, për nga forca e zbatimit, e barabartë me ligje të plota të një pushteti shtetëror të organizuar mirë e me një centralizim të theksuar rreth majës së shtetit. Mungonin në të: një ushtri e rregullt, një forcë e specializuar dhe e gatshme për zbatimin e rregullave të rendit publik, gjyqet e natyrës shtetërore, mungonin burgjet. Rrjedhojë e këtyre mangësive aq jetike, është zhvilluar, ndër të tjera, instituti i vetëgjyqësisë, dokja e hakmarrjes, e gjakmarrjes: *"sy për sy e dhëmb për dhëmb"*. Pra, në radhë të parë, *"veten ruaje vetë e përgjigju kundërshtarit me të njëjtën monedhë"*, ndryshe mund të jesh i asgjësuar. Gjakmarrja, në thelb, nuk është thjesht një doke popullore, një mendësi, (se populli gjithherë i ka kërkuar zgjidhjet paqësore), pavarësisht se forca e traditës këtu është e konsiderueshme, por mbi të gjitha, ndoshta kjo ishte e vetmja e më e sigurta mundësi për të zgjidhur konfliktin e egër, me peshë tepër të rënduar, në një rast a në një tjetër. Rregulli e detyrimi përmbushej nga kushti: *"Kush bënte krim e paguante deri më një"*; *"kush vret vritet"*. Pra, rruga e zgjidhjes ishte mjaft tragjike.

Këto norma dokesore, pra ligje popullore, nuk qenë statike e të dhëna njëherë e përgjithmonë, po nga koha në kohë pësuan ndryshime bashkë me bashkësitë fshatare, që u shërbyen prej tyre: Shpesh herë në popull thuhet: *"në kanun të vjetër norma është kështu"*, ndërsa në *"kanun të ri"* është ndryshe, ta zemë, *"gjakmarrja si fshat"* për 24 a 48 orë, pastaj si fis, si shtëpi ose vetëm për dorasin (vetëm për vetë autorin e krimit), ndërsa më vonë është kufizuar në familje.

Me të vërtetë administrata shtetërore në këto malësi nuk qe e qëndrueshme, po në disa raste doemos atje pati të tillë, qoftë dhe për emër e bëheshin përpjekje të vazhdueshme për ta nënshtruar popullsinë, për ti vënë rregulla shtetërore, për ti marrë taksa e ushtarë, për ta bërë të bindur ndaj ligjeve të shtetit. Një autoritet të veçantë në këto bashkësi fshatare kanë pasur dhe priftërinjtë e vendit,

hoxhallarët, etërit e dervishët bektashinj, urdhrat e ndryshëm fetarë, krishterë a islamë. Në këto kushte e rrethana historike, e drejta dokësore e maleve pësoi ndikime, sadoqë anësore, nga ligjet bizantine (në kohën e Bizantit), nga ligjet sllave (në kohën e pushtimit sllav), nga ligjet veneciane (shek. XIIV-XV), nga kanonet kishtare greko-ortodokse, nga kanonet romano-katolike, nga sheriami i islamit. Mendojmë se ndikimet e huaja të ligjeve shtetërore në këtë të drejtë dokësore janë futur më së shumti nga krerë vendës që kanë qenë ndërkohë dhe përfaqësues të pushtetit shtetëror, norma që bien në kundërshtim me frymën popullore demokratike të kanunit të bashkësive të lira fshatare.

Si rrjedhojë, e drejta dokesore shqiptare, me variantet e saj sipas krahinave, na paraqitet në disa shtresa kohore (të brendshme) dhe me ndikime të jashtme. Kemi kompleksin e madh e më themelor të normave me origjinë vendëse: në forma të lashta ose dhe më të evoluara. Kemi pastaj edhe elemente që kanë hyrë nën ndikimin e kodeve të ndryshme: shtetërore e kishtare, sipas kohës dhe vendit. Në Shqipërinë e Jugut deri diku është zbatuar instituti i marrë nga e drejta bizantine: *shëmtimi* - prerja e veshit, e hundës, e dorës; po kështu dhe norma po të asaj origjine, si sipër, *poshtrimi i gruas*: gruaja e zënë në faje të rënda shëtitej nëpër fshat hipur mbi gomar me fytyrë nga bishti (i gomarit). As në Jugun e Shqipërisë këto institute nuk janë vendëse e janë zbatuar në raste tepër të rralla. Në pjesën më të madhe të rasteve, për hulumtuesin, dallohen, në këtë ligj, dukuritë e lashta ose të evoluara vendëse nga ato që kanë hyrë si ndikim nga jashtë, po ka dhe raste ku elemente vendëse e ato të hyrë nga jashtë janë sinkretizuar e nuk mund të dallohet brumi vendës nga ai i ardhur nga jashtë si ligje shteti e shkrirë me të parin.

5. Shtresime të hershme e të mirëfillta

Normat me brendi më arkaike quhen në popull "Kanune të pushkës së gjatë". Kemi elemente të ligjeve të vjetra që, si vëren Fr. Nopça, ekzistojnë vetëm "de jure", ndërsa të tjerat janë të pranishme "de jure" e "de facto". Shtresime të reja mund të kenë hyrë në veprim dhe disa shekuj më parë, po bashkëjetojnë me shtresimet më të vjetra e, në raport me to, quhen "të reja". Ka mandej elemente të ardhura nga kode të administratave të pushtuesve të

ndryshëm, nga kode krishtere a të islamit. Shpeshherë, kodifikuesit e së drejtës dokesore, duke mos qenë specialistë të fushës, nuk i kanë vënë re këto ndryshimësi. Pra, i kanë futur të tëra në një sistem të njëjtësuar. Në këtë vazhdë, edhe studiuesit, duke mos qenë eksplorues të mirëfilltë, shpeshherë, të tëra i kanë marrë të mirëqena e të barasvlershme, pavarësisht se ndryshojnë në brendi njëra shtresë nga tjetra, sepse u takojnë kohëve të ndryshme, mendësive të ndryshme, formacioneve shoqërore krejt të ndryshme. Po japim veçori mirëfilltësore vendëse të kësaj të drejte dokesore, që shprehin barazi, ruajtje të nderit e të dinjitetit të çdo njeriu, si një forcë ekuilibri e kohezioni krahinor e ndërkrahinor:

A. Normat me natyrë juridike, po ndërkohë dhe morale e psikologjike, në përgjithësi, janë vendëse e të mirëfillta me burim të lashtë.

B. Normat kanunore që përfaqësojnë shtresimet më të vjetra e më vendëse të kësaj të drejte, shprehin një barazi të plotë në mes anëtarëve të bashkësisë krahinore, pavarësisht nga pozita shoqërore në bashkësi, qofshin këta kryeparë, krerë, pleq, gjyqtarë, stërpleq, vegjëli e tjerë. Si të drejtat, si detyrat, si ndëshkimet, ishin të njëjta për të gjithë, si shtëpi, si mashkuj, si fshat: *"Si i miri, si i keqi janë barabar: I miri del prej të keqit e i keqi prej të mirit"* (KLD, f. 121, neni 593, EDZSH, f. 123, neni 121).

Në kanunet e kodifikuara e të botuara vëren dhe gjëra kundërthënëse në norma të ndryshme; disa kryeparë krahinash paraqiten herë - herë si autoritete të plotfuqishme e absolute; natyrisht, këta janë të veshur me pushtet të administratës shtetërore vendase a të pushtuesit e kanuni për ta nuk ishte veçse një mbulesë e ligjeve e urdhrave të dhënë nga lart. Në raste të tjera, krerët, kryeparët, zotërinjtë, paraqiten në të njëjtat botime si *"të parët në mes të barabartëve"* ("primus inter pares") e asgjë më tepër. Kështu, Kuvendi i tërë bashkësisë së një fshati, të një dheu a të një krahinë përbëhet nga krerët e mëdhenj e të vegjël, nga stërpleqtë, nga djemtë e fiseve, e nga vegjlia burrë për shtëpi e ky ushtron pushtetin në fshat, në dhë e në krahinë. Kuvendet ishin organizma vetëqeverisëse e me natyrë demokratike. Vegjelia këtu kishte peshë të madhe në vendime, në besëlidhje, në risime të kanunit. Pa përkrahjen e vegjlisë, as krerët nuk mund të merrnin e të zbatonin vendime e besëlidhje të rëndësishme. Sipas kanunit, po shkelën rregullat, *"dënoheshin*

njëlloj si vegjlia edhe krerët e kryeparët. Për të gjobitun e të laçitun të një kreu mjaftonin pleqtë, stërpleqtë e vegjlia e vendit” (KLD f. 103, neni 1555). *“Me u çue kush prej vogjliet e me vra ndonji prej krenësh a Gjomarkajsh bjen në gjak si për vrasë të çdo njerit*” (KLD, f. 103, neni 1156). *“As dera e Gjomarkut, as krenët e fiseve e as pleqtë e katundeve s’munden me pasë ndonji tagër mbi gja e pasuni të të tjervet*” (KLD, f. 103, neni 1159). *“Çfarëdo fjale e pune me vue dera e Gjomarkut, po s’i ndejtën a s’e pëlqyen krenët e dheut, s’ngul e s’xen vend*” (EDZSH., f. 135, D.GJ. f. 13). *“Ligje të reja kanunore a ligje detyruese kanë të drejtë të bajnë vetëm populli: pari e vogjli”* (KS. f. 16, nenet 20-27). Këtë e tregon qartë dhe vrasja e pleqërimit (grykimit) të pleqnarit që nuk gjykon me drejtësi. Mblidhet bashkësia në kuvend, qet pushkë përpjetë e kështu pleqnari pushon së qeni i tillë.

Këto kanune, duke qenë se pasqyrojnë mendësi e organizime të bashkësive të lira fshatare, kanë natyrë tepër demokratike e respektohen të drejtat e fjala e çdo anëtari të bashkësisë.

Por një pabarazi e fortë me natyrë patriarkale ekzistonte në mes meshkujve e femrave: *“Të drejtë trashëgimie në pronën e paluajtshme”* (shtëpi e tokë) *nuk kanë gratë e vajzat*”. Për shumë gjëra të jetës familjare nuk pyeten gratë ose, së paku, nuk vendosin ato, por vetëm burrat. Në kuvende marrin pjesë vetëm burrat dhe femrat e konfirmuara virgjëresha me 12 pleq dorëzanë. Është e vërtetë se në jetën e familjes sundonte mendimi, veprimi e vendimi i burrave. Megjithatë, gratë a virgjrat, në raste të veçanta, sipas kushteve të mundshme, kanë marrë pjesë në luftë e në konflikte të ndryshme sociale e kanë përjetuar rrjedhojat fatkeqe të këtyre përplasjeve, krah për krah me burrat; ato kanë treguar trimëri të pazakontë e aktet e tyre janë përjetësuar në këngë e legjenda, në tregime historike e në piktura.

C. Sistem patriaral mesjetar: gruaja e vajza me të drejta të kufizuara në familje. Pozita e tyre e nënshtruar ndaj burrave.

Ç. Me gjithë pozitën e saj si e nënshtruar në familje e në shoqëri, të pranishme në bashkësitë fshatare në Shqipëri të Epërme e në tërë Jugun, femra shqiptare kishte dinjitet e mbrojtje nga ligji dokesor. Gruaja e vajza, kudo që të ishte, në shtëpi a në rrugë, ishte e mbrojtur nga çdo cënim a përdhunim, sado i vogël. Nëse cënohej femra, cënohej rëndë nderi jo vetëm i familjes, por i tërë fisit, i fshatit e i krahinës. Nga kjo shpërthente konflikti i ashpër.

Cënuesi dënohej rëndë nga bashkësia fshatare, deri me grimje (vrasje) që bëhej bashkërisht nga bashkësia fshatare.

Në këto ligje popullore, gruaja kishte të drejtën e ndores. Nëse një i rrezikuar të vritej nga kundërshtari, i binte në ndore (i kërkonte mbrojtje) një gruaje e cila edhe e shoqëronte rrugës; aq më tepër kur ajo kish dhe një fëmijë të vogël në krah a përdore, i kërcënuari për tu vrarë ishte i mbrojtur; kështu udhëtonte pa frikë se ishte në ndore të një gruaje. Dijetarë të huaj eksplorues, që kanë shëtitur viset malore të Shqipërisë së Epërme, janë çuditur e shkruajnë sesi është e mundur që një njeri që ka vrarë në çast, e sheh të ecë lirshëm mes njerëzve, pa frikë se është në ndore të një gruaje me fëmijë të vogël në krah e që e shoqëron vrasësin. Doke tepër interesante!

Kur në një grumbullim të rastësishëm njerëzish nga malet (në treg, në punë, në kuvend, në rrugë) shpërthente papritur një grindje që kalonte në konflikt me armë, po të ndodhte aty një grua me një fëmijë të vogël, ajo, duke ngritur fëmijën përpjetë, thërriste: "*Pashi Zotin, burra, ulni armët se batë kërدين!*" Nga kjo, armët uleshin menjëherë, konflikti pushonte e burrat i kthenin shpinën njëri-tjetrit e iknin secili në punë të vet. Të huajt që i kanë përjetuar ngjarje të tilla, janë çuditur nga ky autoritet i madh i gruas sa të ndalojë vrasjet me anë të një thirrjeje. Këtu, natyrisht, duhet marrë parasysh dhe prania e fëmijës si simbol idhulltar i jetës për mendësitë e shoqërive tradicionale malësore; doemos, autoriteti i shenjtëruar i gruas zinte një vend qendror, ndoshta doke me prejardhje nga një kohë tejet e lashtë.

D. Në këtë ligj popullor është tepër domethënësi nderi e dinjiteti i njeriut: Fyerja publike, rrahja e poshtërimi publik ishin të ndaluar rreptësisht. Dënimet për faje ishin të rënda, por jo me akte poshtëruese. I vrari, sipas normave dokesore, nuk mund të plaçketej e as të shëmtohej, ti merrej arma. Akte të tilla ndëshkoheshin rëndë nga bashkësia fshatare, deri dhe me pushkatim. Burrit nuk mund ti thuhej "rren", se këtë të fundit e ndante shpeshherë vetëm gryka e pushkës. Duhej shpjeguar me mirësjellje se ky problem: "*si e gjykoj unë, nuk është kështu..., po ashtu...*".

Dh. Normat e kësaj së drejte, në shumë raste, kanë karakter moral, besimor e juridik. Prona private në kanun konsiderohej e shenjtë e ndahej me kufij. Kanuni thotë: "Kufini i ngulun një herë nuk luhet ma". "*Eshtnat e vorrit e guri i kufinit faqe kanunit janë baraz*".

Kemi këtu përcaktim juridik, moral, po që e ruan nga të cënuarit dhe besimi në fatkeqësi. *Besa e betimi*, kanë një natyrë me vlera morale të përcaktuara mirë, por e kundërta, nëse nuk respektohen, ka për to sanksione juridike e fetare. Në shumë raste, këto janë të ndërthurura me rite e besime. Për thyerjen e besës dënoheshe jo vetëm nga gjykimi popullor, ose dhe si cënim moral, por dhe nga forcat e mbinatyrshe: "*Beja ka rrfenë*", që do të thotë se, po bëre be në rrenë, perëndia të gjuan me rrufe e me pasoja të tjera fatkeqe të kësaj natyre. Edhe respektimi i ekzogamisë kishte natyrë morale, juridike, po dhe mbrojtje nga forcat e mbinatyrshe të paganizmit.

E. Kjo e drejtë dokesore ka ardhë e gjallë dhe e fuqishme deri në kohë të re, duke qenë se kryente disa funksione shoqërore jetike në bashkësitë fshatare; ka qenë një mjet i fuqishëm mbijetese të këtij populli, e marrë brenda kompleksit kulturor të traditës. Në mungesë të një shteti kombëtar për tërë trojet shqiptare dhe i ligjeve përkatëse shtetërore të kombit, ajo ishte një mjet mbrojtjeje e lidhjesh krahinore e ndërkrahinore, mjet i shprehjes së ndërgjegjes kombëtare, ligjë për të vënë rregull në bashkëjetesë fshatare e krahinore, i veprimtarisë atdhetare, i ruajtjes nga nëpërkëmbja prej të huajit; ka qenë mjet i konfirmimit të unitetit kombëtar. Por ajo ka qenë dhe një mbështetëse e formave tepër arkaike, mesjetare, patriarkale në jetën e organizimin shoqëror të malësive.

Ë. Në përmbajtjen më thelbësore të instituteve kryesore në tiparet më të mirëfillta vendëse, kjo e drejtë popullore ishte e njëjtë si për malësitë e Shqipërisë së Epërme, po ashtu dhe për Jugun (Labëri etj.), pavarësisht nga ndryshime krahinore, "*dialekte*" e "*të folme*".

Duhet theksuar se kjo e drejtë popullore shprehte gjendjen e mendësitë e njerëzve të lirë, krenarë, të panënshtueshëm; dinjiteti e të drejtat e personit ishin të një shkalle të admirueshme, por gjithnjë në përputhje me një botëkuptim mesjetar patriarkal, ku zgjidhja e konflikteve bëhej me mjete të egra, shoqëruar me ngjarje të dhimbshme.

Këto norma ka kohë që kanë dalë nga përdorimi i dobishëm. Kjo e drejtë është një monument kulture në duar të studiuesve: të etnologëve, të juristëve, të psikologëve, të sociologëve, të historianëve. Në të vërejmë të kaluarën etnokulturore të këtij populli, po e tashmja ka dalë nga e kaluara dhe e ardhmja do të dalë nga e tashmja.

6. Mbyllje

Kjo e drejtë dokesore është dëshmi e aftësive krijuese të shqiptarëve në fushën juridike, për të vënë rregull e ekuilibër social me veti kombëtare, ashtu si ia kërkuan praktika e rrethanat e jetës. Për t'u vetëqeverisur, populli krijoi, ruajti e zhvilloi ndër shekuj ligjet popullore të tij.

Kompleksi i etnokulturës shqiptare e, në të dhe e drejta dokesore shqiptare, duhen njohur në themel për të kuptuar sesi ka mbijetuar ky popull e ku i ka pasur energjitë shpërthyesë në kalimin përmes dallgëve të egra të historisë. Lufta për mbrojtjen e kulturës etnike ka qenë qëndresë për mbijetesë. Psikika e njeriut të lirë e liridashës, të panënshtueshëm, krenar, me ndjenja të theksuara të barazisë, të së drejtës në bashkësitë e lira fshatare kanë qenë burim i energjive shpërthyesë për progres shoqëror e kombëtar.

Disa mbijetoja të kanunit gjallojnë diku-diku dhe sot dhe bëhen pengesë në emancipimin shoqëror. Në kohë të sotme, normat kanunore duhet të zëvendësohen tërësisht nga ligjet e formuluar nga legjislatorët specialistë, ligje unike për tërë kombin. Me norma dokesore mesjetare shoqëria bashkëkohore nuk mund të ndërtohet e të ecë përpara. Në hartimin e zbatimin e ligjeve moderne juristët doemos duhet të bazohen në elemente të veçanta të së drejtës dokesore, se ato shprehin psikikën e praktikitetin e popullit, urtinë e tij me ngjyra kombëtare e si trashëgimi e shekujve.

Literatura e shfrytëzuar:

Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD), mbledhur e kodifikuar nga Shtjefën Gjeçovi, Shkodër, Shtypshkronja Françeska re, 1933.

Kanuni i Skanderbegut (KS), mbledhur e kodifikime nga Dom Frano Ilia, Brescia (Italia), Editrice La Rosa, 1993.

Kanuni i Lekë Dukagjinit - Varjanti i Pukës (KLDP), mbledhur e kodifikuar nga Xhemal Meçi, Tiranë, Sh. B. Çabej, 1996.

E drejta zakonore shqiptare (EDZSH), Tiranë, Akademia e Shkencave, 1989.

Dorëshkrimet e Gjeçovit (DGJ), Arkivi Etn. i Inst. të Kult. Popullore, Tiranë.

Rr. Zojzi, *Mbi të drejtën kanunore të popullit shqiptar*, "Buletin për shkencat shoqërore", Tiranë, Botim i Institutit të Shkencave, 1956, nr. 2, f. 144-151.

Rr. Zojzi, *Aspekte të kanunit të Skënderbeut të para në kuadrin e përgjithshëm të së drejtës kanunore*, "Studime historike", Tiranë, USHT, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967, nr. 4, f. 173-182.

I. Elezi, *E drejta zakonore penale e shqiptarëve*, Tiranë, Sh. B. "8 Nëntori", 1983.

I. Elezi, *E drejta zakonore e Labërisë në planin krahasues*, Tiranë, Sh. B. Libri Universitar, 1994.

A. Luarasi, A. Anastasi. "Çështje të historisë së shtetit e të së drejtës"(ÇHSHD), Tiranë SH.B. Luarasi 1997.

M. Tirta: Ekspedita kërkimore bërë në vitet 1955-2005; në tërë trojet shqiptare, përfshirë edhe vise të Kosovës e të Maqedonisë Perëndimore (me popullsi shqiptare). Materiale të depozituara në Arkivin Etnik të IKP, ose dhe në arkivin vetijak në shtëpi të tij.